



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pratma - Primbje Me Data: 23.07.2025			
Nr. Llogarit Org. Broj	Numri Broj	Shtetper- Futuraj	Vlera Vrednost
07-	060/07-10	58	



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## FTESË

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e VII të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **29.07.2025 (e Martë)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti. Mbledhja është e hapur për publikun. Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

## Rendite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Kuvendit Komunal.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2025
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës se Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2026.
4. Informatë nga DKA-ja, përfundimi i vitit shkollor 2024/2025.

Viti, më 22.07.2025

Kryesuesi i Kuvendit  
Bekim Azizi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### I MBLEDHJES SË GJASHTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhja u ftua dhe u kryesua nga z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Ajo u mbajt më **30.06.2025 (e hënë)**, në shtëpinë e kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani”, duke filluar punimet në ora **10:00**. Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi; nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: z.Ramadan Deliu, znj.Valentina Mehmeti, z.Illir Zuka, z.Ekrem Ymeri, zn.Arbnora Hajredini, z.Basri Sylejmani, z.Jakup Demiri, zn.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emini, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, znj.Majlinda Shabani, z.Durim Sylejmani, zn.Lindita Demelezi, zn.Vilsona Maliqi-Salihu, z.Reshat Azizi, z.Taulant Haxhiu, zn.Anisë Zejnullahu. Pjesëmarrës të tjerë: drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të Zyrës së Kryetarit, përfaqësues të mediave elektronike dhe të ftuar të tjerë. Munguan: z.Sokol Shaqiri, zn.Zejnepe Osmani, z.Sokol Hyseni, zn.Marigona Avdiu, z.Ali Bajrami, z.Musli Neziri, z.Veton Ramadani, zn.Zyrafete Rama. Pasi u konstatua prania e 19 anëtarëve të Kuvendit Komunal, kryesuesi e shpalli të hapur mbledhjen, duke theksuar se pritet që edhe anëtarë të tjerë të bashkohen gjatë zhvillimit të saj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e gjashtë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Materialin e keni marrë me kohë, dhe gjatë kësaj periudhe prej seancës së kalume, jemi tu e prit konfirmimin e ligjshmërive të akteve nga seanca e fundit. Zakonisht afati është 30 ditë, por 30 ditë nuk janë bërë që janë dërgu, dhe besoj që brenda afatit ligjor do të kthehen edhe ligjshmëritë nga seanca e fundit. Para se ta hapim debatin, e dimë që kohës së fundit kemi pas dëme jashtëzakonisht nga të reshurat dhe breshëri, erërat që kanë qenë në Komunë të Vitisë. Ju bëjë thirrje të gjithë atyre që kanë pas dëme, në të lajmrohen tek komisioni që është i formuar për dëme. Besoj që komisioni dalin e verifikojnë pjesën e dëmeve që janë bërë. Para se të hymë në rend të ditës, kemi pjesën për pyetje dhe përgjigje. Fjala është për juve.

**z.Illir Zuka:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Para kësaj seance kam bërë një kërkesë Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, tu e ditë oborrin e ambulantes që ka pas shumë insekte, ka pas edhe ankesa të mëdha, se në atë pjesë ka pas edhe gjarprinj. Uroj drejtoreshë të merrni masa që ta pastroni atë pjesë, se është shumë rrezik edhe për njerëzit që shkojnë me u shëru. Kryesues, dashta me u ndërlihdh me ty, se pjesë e dëmeve ka qenë edhe Pozherani, Zhitia, një pjesë e Skifterajt. Dje ishim në teren me drejtorin e bujqësisë dhe kryetarin. E pamë që ka shkaktuar dëme, por përveç saj është që ka pas dëmtime të rrymës, që Pozherani nuk ka pas rrymë 24 orë, mirëpo në pjesën ku është bërë rregullimi, aty një pjesë të madhe të pronës ku kanë punu KEDS-i e kanë dëmtu. Ka pas grunaja dhe misër të mbjellur. Përveç saj, për këto dëmtime a duhet me ju drejtu KEDS-it apo edhe ato duhet me shku tek Drejtoria e Bujqësisë.

**z.Jakup Demiri:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja parë është për komunën që ka rënë breshëri në ditën e premte. A keni ndonjë analizë nga terreni, sa janë dëmet e shkaktume, sa janë numri i fermerëve, dhe a keni parapa diçka në mënyrë urgjente për ndihm atyre bujqve që janë të dëmtuar? Dhe për trotuarët në Komunën e Vitisë, që janë të pa përfunduara që një kohë të gjatë. Kur do të përfundojnë, tu e përfshi trotuarin në fshatin Smirë dhe disa fshatrave të tjera, që kam dalë i kam shiku, vetëm se është ajo gjendja e pa përfundime që 4 vite e tepër, dhe me këtë pyetje po e lidhi me rrugën të vorret qendrore në Smirë, që i kemi pjesën më të madhe të vorreve që kur është rregullu rruga për mal është dëmtu shumë rruga prej lumit e deri te varrezat, thuasje është dëmtu diku 50% e rrugës, e që është investim i banorëve me kontribut të vet banorëve që e kanë shtrur pjesën më

të madhe të asaj rruge, dhe ajo rrugë është dëmtu tej mase. Edhe më herët kemi diskutu, dhe është pas zotu komuna që, do të delë ta shikoj gjendjen si është, por nuk e di a kanë dalë. Dua të di a do të merrni masa.

**z.Taulant Haxhiu:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Pyetjen e parë e kam shumë të rëndësishme rreth anulimit të konkursit në Qifllak dhe në Drobesh. Është anulë konkursi për shkak që nuk kanë qenë të pranum njerëzit e juaj. U sulmu në Zyrën e Kryetarit. I ftoj organet e rendit, që edhe njëhere ta shohin se si është sulmu Arian Alidema në prezencë të z.Hasan Aliut, nga kryetari i komunës. Unë kam bisedu me Arianin personalisht, ai është sulmu dhe është kap për fyti nga kryetari i Komunës, Sokol Haliti. Komuna e Vitisë nuk është e Sokol Halitit. Ai nuk mund me kap për fyti kërkan, se nuk ka të drejtë, e sidomos një shërbyes civil. Plus mua më bënë mu habit, se mos të ishte Melihati, tha mu ndal fryma, po Milihati na dajti, se Hasani veç kqyrke çka po ndodhë. Kjo është e patolerushme për një konkurs, dhe e keni anulë konkurset. Po unë e ftoj dhe një here policinë, prokurorinë, që edhe një here të merret me rastin e Arian Alidemës. Nuk guxon asnjë shërbyes të kapet nga një Kim Jong King siç është Sokol Haliti. Kërkesa ime e dytë. Kam fol qe 1 vjet për bllokimin e sheshit. A jeni tu e pa ku keni ardhë. Të gjitha bizneset sot janë të pakënaqura, të gjitha bizneset sot kan 50% qarkullim më pak se sa vitet e kalume. Ne ja u kemi dhanë një shesh, por i kemi blloku. Hin në qytetin e Vitisë, i ke 10 lokale tu dhanë me qera. Tregom ti, kur të vijnë edhe 10 mijë banorë mërgimtarë, ku kanë vend në parking, çka keni bënë për ta, çka keni mëndu? Unë nuk po mujë me parku kerrin. Unë e kam lanë kerrin atje poshtë, por llogaritne që vijnë dhe nja 15 mijë banorë që vijnë. A keni mëndu për ta, a doni krejt me i qu në Gilan, Ferizaj. Ai nervozohet kur ta sheh të bllokume Vitinë, shkon dhe i lë paret në Gilan dhe Ferizaj. Po i dëmtoni bizneset. Pyetja 3, unë dje kam pas një takim me taksistat e Komunës së Vitisë. Taksistat ku e kanë lokacionin sot, janë krejt të paknaqur. Beso që, çdo taksist tha për 80-90% na ka ra qarkullimi. Ata janë qytetar, janë qytetarë tanë, janë njerëz që mbajnë familje prej taksit. Kërkesa e tyre është i nderuari Aliu, të jenë te Tribari deri tek 2 kontinjerat që janë përball parkingut privat. Aty thanë që janë mirë, këtu nuk po ja vlenë, se as 6 euro në ditë nuk jemi tu bënë qarkullim. Ata mbajnë familje. Nuk është interes i askujt të ja ndalim bukën e gojës asnjë qytetari të Komunës së Vitisë.

**z.Basri Sylejmani:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! I shprehi keqardhje fermerëve të Vitisë që kanë pas dëme dhe nëpër shtëpi dhe nëpër toka bujqësore. Ishalla don Zoti e më nuk përseritet. Komisioni është formu me bënë vlerësimin e tyre. Pyetja parë është për një rrugë në Qifllak-Novosellë, dhe rruga e Sllatinës “Skender Ramadani”, Rruga “Zeneli” në Skifteraj është moti në projekt, por e cila nuk u bënë deri sot.

**zn.Lindita Demelezi:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Në pyetjen time ju bashkangjitem kolegut: pse janë anuluar konkurset e fundit për çerdhen në Drobesh? Kërkoj sqarim nga shefi i personelit. Pyetja tjetër: pse nuk është miratuar rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës? Pyetja tjetër është që, në disa seanca të mëparshme kam ngritur shqetësimin lidhur me ndriçimin publik të lënë përgjysmë nga shkolla Sllatinë në drejtim të Pozheranit. Kjo rrugë është shumë e frekuentuar nga banorët e fshatrave përreth, si dhe nxënësit që udhëtojnë çdo ditë në këto 2 drejtime. Përveç mungesës së ndriçimit, edhe trotuari është në gjendje të keqe ka dëmtime të kubzave, ndërsa pjesa më e madhe është e mbuluar me bari, gjë që e vështirson lëvizjen e këmbësorëve dhe rritë rrezikun e aksidenteve, sidomos gjatë orëve të mbrëmjes, prandaj kërkoj nga ju që të bëhet një zgjidhje e shpejt e përfundimit të ndriçimit publik, dhe të merret masa për mirëmbajtje dhe pastrimin e trotuarit.

**z.Nexhat Halili:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja e parë ka të bëjë me ujin e pijes. Shumë fshatra në Komunën e Vitisë kanë nevoj për ujë të pijes, ujë për amvisëri etj. Shpesh nëpër seanca, takime dhe aktivitet të ndryshme është ngritë çështja e ujit të pijes, mirëpo rezultatet deri më tani janë mos të themë të barazume me 0. Në disa vendbanime është instalu rrjeti i ujësjellësit, në disa është në proces, në disa tjera nuk është fare fillimi i instalimit të rrjetit të ujësjellësit, ujësjellësi i cili lidhë 5 fshatarat: 2 Sllatinat, 2 Sodovinat, Trestenikun, i cili është duke funksionu në disa lokalitete, edhe pse nuk mund të përdoret për pije, por të paktën përdoret për amvisri. Problemi është se, në disa lokalitete janë të kyqura vendbanime të rrjetit të ujësjellësit, por ujë nuk kanë fare, dhe më e keqja është se, lagjja “Simigjiu” në fshatin Trestenik, e cili e ka diku afër 20 metra bazenin, mirpo prej ati bazeni ujë nuk mund të përdoret as për amvisëri e mos të falsim për pije. Në buxhetin e

Vitisë për vitin 2025 është parpa vlera 40 mijë euro, dhe në 2026 vlera 20 mijë euro për projektin, funksionalizim të ujësjellësit në fshatrat Zhiti, 2 Sllatina, 2 Sodovina, Trestenik, Dobolde. Ky projekt është edhe në planin e prokurimit për vitin 2025, i cili është planifikuar të filloj procedurat e prokurimit nga muaji mars, diku me 17.03.2025. Kanë kaluar më shumë se 3 muaj nuk është marrë asnjë hapë në këtë drejtim. Kur do të fillojnë procedurat e prokurimit, në mënyrë që edhe këto lagje vendbanime të cilat kanë mungesë të ujit të kyqen dhe të kenë ujë në të ardhmen. Pyetja tjetër ka të bëjë me grandin e performances për vitin 2021, i realizuar në vitin 2023-2024. A mund të na tregoni vlerën e grandit të performances për vitin 2023. Sa projekte janë të përfshime në këtë plan a është vlera e shpenzuar e këtij grandit dhe pse nuk është shpenzuar grandit në përgjithësi, por një pjesë e këtij grandit është kthyer mbrapa, dhe një pyetje kam për drejtoreshën e shëndetësisë. Në fshatin Sllatinë e Epërme është ambulanta, e cila funksionon e vetme me 2 infermiere, por mjek të përgjithshëm nuk ka. I ka gati më shumë se 2 vite ku mjeku i cili ka punu në atë ambulant ka dalë në pension, mirëpo prej atëherit nuk është bërë zëvendësimi. Kur duhet të bëhet zëvendësimi, që të ketë mjek në atë ambulant? Dhe një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike. Oborri i ambulantes është i kapluar prej barishtave, nuk e ka pastruar askush. Me këtë pyetje nderlidhet dhe ambulanta e Qendrës së Mjekësisë në Pozheran. Tek analizat në katin e dytë janë 3 banjo, 2 nuk funksionojnë. Pse është kjo gjendje?

**z.Sejdi Emini:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kam pyetje të cilat i kam bërë edhe 2 seanca më herët, mirëpo deri sa kemi kërkesa të qytetarëve, ne jemi këtu për ato kërkesa. Tek rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës është një kërkesë që pothuajse do të hasim në qytetarë dhe në punonjës të shërbimit civil në Komunë të Vitisë, që konsiderojnë që ju bëhet e padrejtë. Sa ju përket pagave të tyre, e dimë që shumica e tyre mbajnë familjet me ato paga, dhe shumica e komunave e kanë rregullu këtë çështje. Unë mendoj që është një padrejtësi e madhe ndaj tyre dhe familjeve të tyre. Pse është vonu, nuk e di, mirëpo mundem me thënë me plotë përgjegjësi, nëse lëvizja vjen në pushtet, qysh në muajin e parë kemi me rregullu këtë punë. Po kahet shumë me lotë krokodilit sa i përket breshërit nëpër fushat, sidomos të Skifetrit, Kllokot e Radivojc. Një pjesë prej jush jeni dëshmitar që, që 3 mandate jam dhe kam kërku që me qenë një stacion meteorologjik për matjen e kohës dhe shpërndarjen e breshërit, që mos me i lanë me i dëmtu kulturat bujqësore. Nuk e di a e ka lodh kush kokën për këtë çështje, mirëpo unë si fëmij kur kam qenë, e di që kanë funksioni disa metoda të tilla në fshatin ku kam qenë unë. Tash në këtë kohë nuk e di se ka lodh kush fare kokën dhe tash normal që bjen breshër mundë me i shkatrru me i demtu mirpo jan njerzit që i bëjnë parandalimet dhe planet afatgjate dhe mendojn gjatë për qytetarin dhe të ardhmen e vendit të tyre. E di që tani është kohë sezonale, është mirë që së paku brenda 10 dite do punë që janë tu punu në disa vende kyqe me i liru rrugët para se me ardh mërgata jonë. Nëse bëhet si është bërë vjet kaos, shumica prej tyre paren kanë shku e kanë lënë jashtë Komunës së Vitisë, sepse detyrohen.

**znj.Majlinda Shabani:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Gjithsecili jeni tu e pa që çështjet të cilat ne për çdo seancë ne i kemi ngrit si shqetësim, janë ato të cilat i përkasin nevojave bazike të qytetarëve të komunës së Vitisë. Është çështja e ujit të pijshëm, kanalizimeve, ndriçimit publik dhe shërbimeve të tjera. Jemi në fund të një qeverisje 4-vjeçare të një kryetari i cili ka 3 mandate qeverisje, edhe është dështimi më i madh që nuk ka arritë për kaq kohë të paktën me pa se sa me seriozitet është tu i trajtu këto problematika, dhe ne si këshilltar komunal, në vend se me u fokusu në politika dhe në çështje të cilat duhet me qenë shumë më të avancume, me zhvillu Komunën e Vitisë, ne prapë po kyqemi pikërisht në këto problematika. E kemi parë që mjafton veç një shi me ra në Komunë të Vitisë dhe me pa gjendjen e rrugëve që bëhen në Komunë të Vitisë. Çështja e parë u përmenden dëmet që janë shkaktu në bujqësi. Përpos kologut asamblist që e përmendi aspektin tjetër qysh në fillim të mandatit, unë e kam ripotencu që është mirë si komunë me parapa dhe politika të reja. Në këtë rast kam propozu që në këto raste me pas një fond rezervë të parpamë pikërisht nga buxheti i Komunës së Vitisë, se e dimë që për çdo vit ne kemi reshje dhe po kemi dëme me të mbjella, dhe ajo çka kam kërku që të bëhet një fond rezervë, që të paktën sado pak me i dalë në ndihmë të këtyre fermerëve. Nuk mundemi me dalë thjesht me i vizitu, me bë një postim në fejsbuk edhe me kaq me u përmbyll kjo temë. Unë po shpresoj që komisioni ka me bë vlerësimin real. Tash e kam parë që edhe ministri ka radh në vizitë, dhe ai ka shpreh gatishmërinë për me i dalë në ndihmë, dhe konsideroj që kjo ka me qenë mandati i fundit për të cilën kemi parë që kryetari nuk është

fare i fokusum në këto politika të cilat e prekin direkt mirëqenien e qytetarëve. Adresimi i dytë ka të bëjë me inspektorët e trafikut. A ka inspektor të trafikut Komuna e Vitisë? Dhe nëse nuk ka, pse nuk ka, dhe gjithashtu mirëmbajta e trotuareve në Komunë të Vitisë, drejtori me na tregu gjendjen e troturave, tu i përfshi dhe fshatrat, me pa se sa janë tu mirëmbajt, sepse ne e dimë që kemi mjete të shpenzuara për mirëmbajtje të troturave, dhe nuk është në rregull që, kur të bëhet një investim mos me mujtë me u shfrytëzu prej qytetarëve.

**zn.Liridona Bislimi:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Dua të diskutoj rreth temës për shtegun e atletikes, që është te fusha sportive në fshatin Drobesh. Kryetari, Sokol Haliti ka ditë me bë një proklamim shumë të madh, ka bë postime në rrjete sociale, video të gjata si një punë shumë të madhe, mirëpo kryetari nuk e di a e ka mëndu që shtegu i atletikes nuk përdret vetëm ditën, qytetarët e shfrytëzojnë edhe natën. Si nuk e ka mëndu ndriçimin publik. Përpos ndriçimit publik, janë edhe barrojat, janë problem i madh, se aty dojnë dhe fëmijët, moshat më të vogla me shfrytëzu si aset i komunës. Nëse kishi mujtë me pas mundësi këtë çështje sa më shpejt për shkak se unë mendoj se, kur është finalizu, ka dashtë me qenë dhe ndriçimi publik si një punë e mirëfillt e kryetarit të Komunës së Vitisë. Nënkryetar, e dimë që jemi tu hy në stinën e veres, kemi pas edhe viteve të kalume një problem të ngjashëm, është çështja për dezinfektimin e territorit të komunës, për problemin e mushkonjave. Mundeni me marrë shembull Komunën e Gjilanit, e cila veç ka fillu një praktikë të tillë. E di që nuk keni fillu me bë, a keni bë ndonjë planifikim nëse filloni me bë kur me fillu me praktikë. Dhe bursat studentore, e keni hap aplikimin, studentët kanë apliku, mirëpo çka është me rëndësi, në vitin e kaluar, në muajin prill ju veç i keni qitë emrat që kanë qenë përfitues, edhe i keni shpërnda bursat studentore. Tash ne po hymë në muajin korrik, nuk ka asnjë lajm, dhe studentet po dojnë me ditë se kur kanë me i marrë ato pare. Ata veç i përfundun ligjëratat realisht, ju jeni tu dashtë me shty sa më shumë, për shkak se është pjesa e fushatës lokale, për me shfrytëzu. Kjo është e ditur, e kemi mësue, është politikë e Sokol Halitit. Dhe çështja tjetër, ka qenë një lloj tronditje edhe për banoret e fshatit Drobesh, për këshillin e fshatit. Kemi pas takime tek çështja e konkursit. Natyrisht edhe për çerdhe në Qifllak, por ne po flasim specifikiisht për Drobesh, se jemi banor të fshatit Drobesh. E dimë, po kuptohet se është term politik, është punë politike, është anulu konkursi për shkak që keni bë një arsyetim shumë jo të logjikshëm, për shkak të zgjedhjeve, kinse kanë qenë nacionale. Zgjedhjet u kryen në muajin shkurt, tash po hymë në muajin korrik, prapë u hapë konkursi i cili ka qenë i gatshëm, prapë është anulu. Ka pas qarkullime të mëdha të emrave, që veç se kanë qenë përfitues të këtyre konkurseve, dhe ne si banorë ndihemi shumë të fyem me këtë situatë që ka ndodhë, për shkak se jemi bë temë diskutimi. I përmend, ajo çështja e kolegut Taulantit, të cilën unë nuk dua me hy me diskutu, për shkak se është jo e hijshme se si insitucion, se në çfarë rrethanash jemi tu përball. Unë nuk e di nëse keni ndëgju ndonjë rast në komuna tjera, këto gjëra që kemi ndëgju këto ditë të fundit, tash po flas sepcifikisht. Na të fshatit Drobesh, se çerdhja është aty, dhe për shkak të këtij konkursi, nuk po flasim veç për konkursin e mësimdhënësit. Ka dal në diskutim që, për një korrik ka kris boksi në Viti. A e kuptoni sa jo e hijshme është? Çka me prit tash na benorët e fshatit Drobesh, nëse për një korrik, për një punëdhënës që është, d.m.th profesionale më të thejsht, të mundesh me u bë gjithë kjo zhurmë. Çka me mendu ne që respektohet ndonjë punë, profesion tjetër.

**z.Ali Bajrami:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Një pyetje për drejtreshen e shëndetësisë. Këtë vit me ngritje të temperaturave kemi edhe një rritje të zvarranikëve. Pyetja është, QKMF-ja dhe AMF-të a janë të furnizuara me vaksina, se vaksina është shpëtim jete i njeriut. Pyetja tjetër për drejtorin e bujqësisë. U fol e u diskutu vetëm. Pyetje direkte: a është komisioni i formum për vlerësimin e dëmeve? Se fermerët e vyshëm në Komunë të Vitisë, me këtë fatkeqësi kanë psu dëme të konsiderushme materiale.

**z.Halil Musliu, drejtori i inspeksionit:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Siç e dini, unë jam frik në këtë drejtori, dhe aty ka qenë një inspektor i trafikut, është anulu konkursi. E di që është largu për shkak të një vendimi nga komisioni i pavarur i shërbimit civil. Tash është konkursi, është bërë pjesa e parë e intervistes, d.m.th Zyra e Personelit e dinë ku janë procedurat, por besoj që së shpejti do të bëhet pranimi. Unë kam kërku që inspektori i komunikacionit i shërbimeve publike dhe i pronës, se është një vakum i madhë në inspeksion. Për 2 e di që është qitë konkursi, dhe është tu bë përzgjedhja për të 3-in kanë thanë që nuk është në plan të personelit.

**z.Naim Pira, drejtori i bujqësisë:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! U parashtru një numër i madh i pyetjeve sa i përket Drejtorisë së Bujqësisë. Po, jemi dëshmitar që, me datë 27 ka ndodh fatkeqësi natyrore, kemi pas të reshura nga breshëri që ka dëmtuar një pjesë të territorit të Komunës së Vitisë, përkatesisht fshatrat Radivojc, Skifteraj, Pozheran, Zhiti dhe një pjesë tjetër të territorit të Komunës së Vitisë. Natyrisht si drejtor i bujqësisë bashkndjej me të gjithë ata fermer që kanë pas dëme për faktin se edhe unë rrjedh nga një familje që tradicionalisht jemi marrë me bujqësi, dhe kur ka dëme të tilla është e dhimbshme, por ne si Drejtori e Bujqësisë jemi angazhu me thanë të drejtën nga momenti i kësaj fatkeqësie të merremi me fermerë, dhe e kemi formu komisionin. Sot e kam parë një vllug të bujqve që kanë qenë në drejtorinë tonë të bujqësisë, me u infromu rreth formës, mënyrës, paraqitje së ankesave. Në këtë drejtim ju kemi ndihmu me zyrtarët e bujqësisë. E kemi bë nga një formular, ja u kemi shkep të gjithëve që me ja lehtsu punën e tyre, në mënyrë që ata t'i adresojnë kërkesat e tyre Drejtorisë së Bujqësisë, mandej të del komisoni ta bëjë vlerësimin e dëmeve. Në bazë të shikimeve vizuale mund të themi se, në këtë pjesë dëmet janë të konsiderueshme, por analizën përfundimtare sigurisht do ta jep komisioni mas daljes në teren te secila parcelë, secili fermer që ka bërë kërkesë. Pat pyetje të natyrave të ndryshe.

**z.Sejdiu e bëri një pyetje:** pse nuk është ndërmarr diçka rreth mbrojtjes siç ka qenë përpara me sistemin e kalum. Nuk është e vërtet që nuk kemi bërë përpjekje në këtë drejtim. Bile me marrë informacione të kësaj natyre dhe informacionet e para janë që kemi marrë, se hapësiren ajrore e menaxhon KFOR-i dhe nuk lejon të vendosen sisteme mbrojtje siç kanë qenë më përpara, kështu që duhet të ketë leje të posaqme nga KFOR-i, dhe këtë çështje e bënë ministria, nuk e bëjnë drejtoritë komunale, duhet me ditë secili. Sa i përket daljes në teren të ministrave dhe zëvendës ministrave, nuk është hera e parë që dalin në teren, bile qe 4 vite sa jam drejtor i bujqësisë, kurrë se kanë parë të arsyeshme me trokit në derën e Drejtorisë së Bujqësisë, me marrë informacione më bazike në lidhje me Komunë të Vitisë, por tash është vit zgjedhor dhe e di që kanë me ardhë të gjithë, kanë me bë përpjekje ndoshta në mënyrë po e quajmë kështu me i manipulu bujqit, sepse qe 2 vite me radhë me plotë kuptimin e fjalës edhe ju si kuvend keni miratu këtu dhe keni votu dëmet të cilat janë bërë në bujqësi, sepse për çdo vit pothuajse ka dëme në bujqësi nga ana e breshrit, shiut etj, dhe ja ku i keni këto vlerësime, që 2 vite nuk ju është ndarë bujqve asnjë cent nga ana e ministrisë, sepse me një udhëzim administrativ në formë politike fondet të cilat kanë qenë në Ministrinë e Bujqësisë kanë kalu në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në Agjensionin për Menaxhimin e Emergjencave. Unë ju kisha inkuraju të gjithëve, edhe ju që keni pushtetin nacional po e thamë, tani është një vakum institucional, po nga minsitrat në detyrë apo deputet ta bëjnë një trysni, bile bujqve të ja u paguajnë jo veç dëmet e këtij viti, por edhe dëmet e viteve të kaluara, sepse edhe viti 2023-2024 bujqit kanë pësu dëme dhe nuk i u është kompenzu asnjë cent, prandaj unë po ju sugjeroj dhe po kërkoj nga bujqit, të gjithë ata që kanë dëme në parcela të tyre, ferma të tyre, t'i drejtohen Drejtorisë së Bujqësisë, të bëjnë kërkesa në mënyrë që të dalim dhe ta bëjmë vlerësimin. Në këtë drejtim nuk kemi me pritu hiq, kemi me dalë në teren dhe ndoshta edhe si kërkesë e imja nëse nuk besojnë kanë të drejtën ministira ta dërgojnë ndonjë anëtarë të komisionit, pse jo për me qenë nëse dyshojnë me qenë vlerësimi më i lartë.

**znj.Merrushe Ahmeti, drejtoresha e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Sa i përket pyetjes së z.Ilirit, më lejo të themë se, Drejtorja e Shëndetësisë nuk ka pajisje për barishte të forta, mirëpo ne jemi në bashkëpunim me z.Aliun, i cili është drejtor i shërbimeve publike. Ne me rastin e informimit e kemi paraqit kontestin tek Aliu dhe më ka premtu që ka me u kry, mirëpo shkaku i disa çështjeve teknike, mirëpo më tregoj më herët se sot do të kryhet si çështje. Kjo lidhet me Sllatinën, do të kryhen si çështje. Sa i përket mjekut në Sllatinë, qe 2 javë nuk është mjeku aty, për arsye se në qendër ka mungesë të stafit mjekësorë, për arsye se është koha e pushimeve, në këtë rast normalisht ata zëvendësojnë njëri tjetrin. Ai do të kthehet të mërkurën. Sa i përket banjove në Pozheran, po janë të mbyllura për arsye se nuk kanë pranim teknik, mirëpo do e shofë mundësinë financiare me futë si çështje dhe me rregullu. Dhe një pyetje nga z.Aliu rreth vaksinave nga zvarranikët. Si çështje, Ministria e Shëndetësisë e parashef që mos me qenë vaksina të tilla në nivel lokal, për arsye se konsiderohet që helmi është diku 2 orë deri 4 orë, dhe si e tillë e parashef që me kalu në nivel regional dhe nuk ju lejohet me ligj që me kalu në nivele lokale.

**z.Basri Aliu, drejtori i shërbimeve publike:** Përhëndetje për të gjithë të pranishmit! Për pastrimin e oborrit QKMF në Pozheran, shpresoj që sot kryehet, sepse është në teren kompania, edhe pse nuk e kemi obligative, por është çështje që duhet me u krye, pa marrë parasysh se cilës drejtori i takon, ne jemi një, ndërsa për taksistat, kërkesë e taksistave ka qenë që me dalë atje, sepse një vendim e kanë pas me qenë këtu, ata prej ktuhit kan lypë me i transfreu atje, d.m.th kërkesa ka qenë e tyre, sesa kanë punë, unë shpresoj që ata të kenë sa më shumë punë, sepse e di që edhe ata mbajnë familje, por ajo nuk varet prej neve, ndërsa vendin e kanë caktu vetë atje dhe e kanë vendos aty me qenë. Dëshira e tyre është. Edhe unë po rri me ta çdo ditë thuajse. Ata po kërkojnë edhe me qenë në qendër të sheshit, por janë disa mundësi që nuk mujnë me u vendos aty. Ndriçimi i rrugës Sllatinë-Pozheran kishte qenë mirë me u bërë dhe aty, por ana financiare. Sa për barnishta, unë kam qenë pardje në rrugën Sllatinë-Pozheran, pjesë pjesë ka nevojë me ndërhy aty, dhe sot do të ndërhyjë aty, por nuk është në gjendje bash si po e paraqet. U përmend edhe për barnishta tjera, realisht rrugën Pozheran-Viti ka përfunduar. Rruga për Binç, edhe aty po. Buzovika ka kërku gjithashtu, edhe atje sot në Sllatinë-Viti sigurisht janë tu punu, se ka pas një defekt makineri dhe do të përfudon dhe ajo rruga që e përmende Pozheran-Sllatinë. Do të ndërhyet edhe në QKMF. Po kemi probleme edhe në rrugë magjistrale, të cilat nuk janë në kompetencën tonë. Ne do t'i shohim mundësitë e buxhetit, a mund të ndërhyjë në rrugë magjistrale apo jo.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Më lejoni të ju përhëndes. Të nderuar të pranishëm! Kam bërë përpjekje t'i shënoj të gjitha pyetjet, edhe ato të adresuara për kabinetin e kryetarit edhe të drejtorave, megjithatë më vjen mirë për shqetësimet e ngritura nga ana e juaj, por unë sot kam pritë fillimin e seancës me diçka tjetër. Nuk dashta me ndërhy deri sa të më vjen radha, megjithatë muaji qershor ishte muaji i rëndë për Komunën e Vitisë, që i kishim 3 humbje në forma të ndryshme, 2 të rinjve dhe 1 të reje. Një e cila ndodhi jashtë territorit të Komunës së Vitisë, në Kaçanik, një në botën e jashtme, serish i ri. Dhe tjetra, serish në botën e jashtme, në mesin e 15 viktimave, prandaj kryesues, me propozimin tim kërkoj 1 minut heshtje.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit nënkryetar! Kërkoj 1 minut heshtje për nderë të humbjes së të rinjve tanë nga Komuna e Vitisë. I leht u qoftë dheu!

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Faleminderit kryesues për mirëkuptimin me respektin për ato familje, duke ju bashkngjitur dhe ne dhimbjes së tyre, ishalla e kalojnë sa më leht humbjen e të afërmeve të tyre. Do të bëjë përpjekje me korrektësi të ju përgjigjem pyetjeve. Ilir, pyetjen e parë, përgjigjen e morre, ndërsa të dytën konsideroj se dëmet të cilat i shkakton kompania, në këtë rast KEDS, që është kompani e privatizuar, konsideroj që kërkesa duhet t'i bëhet KEDS-it, se ato kultura janë prishë duke i mënjanu defektet që kanë qenë, që i ka obligim. Një pyetje të cilën konsideroj nuk u shtru, Naimi për shkak që dulë: a keni ndonjë analizë të terrenit për çështjen e dëmeve të cilët janë bërë. Unë besoj se deri më tani, jo për shkak se komisioni është i formuar, do t'i afrojmë kushte teknike dhe do të jenë në teren që ta bëjnë një vlerësim sa më real konformë normave pozitive që janë në Republikën e Kosovës. E di, se e kam vizitu edhe vetë personalisht terrenin prej Nasale deri në pjesën e Zhitisë, Skifteraj, është një sipërfaqe bukur e madhe, por diku më pak diku më shumë, besoj se tu e pas parasysh profesionalizimin do ta bënë formën më të mirë të mundshme. Çështja tjetër: trotualet kur do të përfundojnë. Unë konsideroj që e ke mirëkuptimin tim, nuk e kam për me të ngucë, veç në momentin që na rimbursojnë këto që na u kanë marrë nga kontrata kolektive, ju e dini që na kanë prishë edhe strukturën e buxhetit, na kanë mbetë shumë projekte në gjysmë, vlere e ka kalu 7 milion e 700 mijë. Nuk janë tu i marrë krejt nga investimet kapitale, por shumë ka nga investimet kapitale. E kam parë, e di se një vlerësim i tillë tash ndoshta me shkrim jo, por e di që inxhinierat i ka qitë kryetari, se ke bërë shumë herë pyetje për atë rrugë, dhe e ka parë që është e dëmtuar, por konsideroj që nuk është e projektuar, se është në mungesë të buxhetit, se sa rrugë është ajo, ka mujtë kur janë mjetet tu e shtru një rrugë tjetër me kalu, dhe atë e kam parë vetë, kam qenë aty. Çështja e konkurseve është e drejt ekskluzive e kryetarit të komunës së abshku me zyrat që i ka, në këtë rast Zyrën e Personelit. Është edhe hapja, por edhe e drejtë anulimi në rsat se konsideron se nuk është çështja e mirë. Dhe unë konsideroj se, është e drejtë e kryetarit dhe e ka bërë atë çështje. Nuk është mirë me i politizu dhe me i zmadhu çështjet, nuk është një realitet që është sulmu personi zyrtar. Është një realitet se politikë mundë të ketë gjithherë, por larg asaj, dhe prandaj nuk është mirë me i keqpërdor këto çështje. Bllokimi i sheshit. Nuk ka çështje që rregullohet pa u blloku.

Në radhë duhet me u blloku e mandej mu rregullu. Unë besoj se pe merrë formën e vetë të cilën e dëshirojnë qytetarët e Komunës së Vitisë e dëshiron edhe ti, dhe një ditë ke me thanë që, me të vërtet u bë bukur. Dëmet për fermer u diskutun shumë. Unë besoj që do të punohet në atë drejtim dhe ajo listë do të ju vie edhe juve këtu, se gjithherë është ardhë në kuvend, për çdo vit kemi pas, por herë më shumë herë më pak. Deri tani nuk është kompenzu, por e drejtë e jona është me evidentu, me vlerësu dhe me dërgu dhe me kërku pagesën. Ishalla këtë vit hasim në mirëkuptim. Besoj se këtë vit hasim, se edhe unë jam idhtar i asaj, janë zgjedhjet, e kanë mirëkuptimin, por megjithatë është me rëndësi me ju dhanë fermerëve, se me të vërtet disa janë dëmtu. Rruga Qifllak-Novosellë, besoj që është pasoj e kësaj kontrata dhe rruga “Zeneli”. Për çështjen e konkursit tu përgjigja. Lindita, çështja e rregullores është në procedurë e sipër, besoj se së shpejti edhe ajo çështje do të rregullohet. E di që një komision është i formum prej anës së kryetarit, deri ku ka ardh nuk e di, e di se kanë punu bukur shumë. A është në përfundim, besoj se duhet me qenë. Nexhat, te uji i pijes, unë e di se kompanisë ja kemi dhanë në mbikëqyrje, dhe i ka disa defekte. Kanë bë një komision, ka qenë me dalë me i kqyrë defektet, me i eliminu. Këto 5 fshatra ka qenë një zhagitje bukur e madhe, për shkak ka pas disa defekte në elektrikë. Është lypë një ekspert i elektros. E di se i kanë ndihmu edhe kompania, njerëzit profesional të kompanisë regjinale dhe besoj që është e përgatitur për me u tenderu dhe mu eliminu do defekte. Grandi i performances nga viti 2021 në vitin 2024. Nuk i di përmendësh, por në seancën e ardhshme do ta kesh formën dhe pse jan kthy. Sejd, për rregulloren the që Vetvendosja ka me rregullu. Ishalla nuk i rregulloni si në qendër, se në rast se i rregulloni si në qendër, ishalla nuk vini kurr, se si model keni tregu se nuk bëni kurgja. Për stacion kundër breshrit. Besoj morre përgjigje, është e nivelit qendror, e keni këtë mundësi, e ke pas Fatonin, ke mujtë me i thanë atë ditë kur ka qenë, pse nuk e ke ndreq, por ndoshta e ke kursy. Jam idhtar i asaj që, sa më shpejt të përfundojmë çështjen e implementimit të këtyre projekteve në Viti, për shkak që duhet të bëjmë përpjekje gjithsecili, që bashkatdhetarët tanë ti presim formën më të mirë të mundshme, edhe ta keni levizshmërinë për shkak edhe të asketit ekonomik, njerëzorë, moral që e kemi ndaj tyre, që besoj që kanë qenë shtyllë e shtetit deri tani, sidomos në aspekt financiar. Linditë, ta kisha pranë këtë me thanë veç po dalin në fejsbuk sa me dalë. Te dëmet në bujqësi. Thuj Fatonit, se ne jemi kompetent. Shko thuj atij ministrit tanë, kur të vish tjetër herë, dije, duhet me thirrë kryetarin e komunës, drejtorin e bujqësisë, kryetarin e këshillit të fshatit, dhe me dalë me vizitu terenin. Është rendi, ka rend institucional. Nuk mund me ardh në oborr të Hasan Alisë pa më thirrë mua, nuk ka kuptim kjo. Këtë e bëni veç ju, por shkoni tregoni atij, duhet me thirrë. Në rast se nuk e dini këtë, ja u mësojmë, por rendi është kështu. Liridona, në plotni pajtoj që duhet me pas ndriçim, por kapaciteti buxhetor ka qenë qaq. Askush nuk thotë që duhet me pas aq, ajo duhet me u shfrytëzu 24 orë, se atë shteg është me fat që e keni në territor të drobeshit, mirëpo ajo është për krejt qytetarët e Komunës së Vitisë. Që ka thënë kryetari është aset i komunës, pa dyshim, edhe ti pajtohesh që është aset i komunës. Dezinfektimin e kemi bë në kohën e pandemisë. Po tregoj të drejtën, në duart e juaja është me i thanë rimbursoni ato që po na e merrni, se kërkesat tona janë 10 apo 15, e nuk është problem me bë dezinfektim, është tema më e mirë e mundshme. Bursat studentore. E di që komisioni e ka përfundu, dhe po ta jap një informacion të mirë prej 150, e di që kryetari ka pru vendim, si zakonisht për çdo vit, jo për vit zgjedhor, por çdo vit, gjithë ata të cilët e meritojnë në kushte të rregullta, në përputhje me rregulloren, i ka nda më duket diku 260 bursa. Nuk e di sakt shifrën. Si çdo vit edhe këtë vit. Pse i kemi shty. Është kanë mungesa e parave. Po na merrni. Kur të vijmë në mëngjes nuk janë. Nuk duhet me u prek. Drobeshi, për çështjen e çerdhes. Çerdhja teritorialisht është në Drobesh, përndryshe ajo do ti shërben krejt lokaliteteve.

**z.Taulant Haxhiu:** I nderuari Nënkryetar! Mua më the që nuk është realitet ajo që ka ndodh në Zyrën e Kryetarit. Arian Alidema mu ma ka thënë, prezent ka qenë edhe Fatlum Demiri. Në qoftë se Sokol Haliti nuk e ka kap për fyti në prezencë tane Arian Alidemen nga Pozherani, kurrë në jetë më me politik nuk mirrna, dhe kurrë në qytet të Vitisë nuk dalë. Je njëfar burri madh, pranoje realitetin. Pse nuk pe pranon që e ka kap për fyti, për shkak të konkursit në Drobesh? Pse nuk pe pranon? Ke qenë prezent dhe nuk ke livrit prej vendit. Ne të njofim si burrë të madh. Mos të kishte qenë Melihatja, tha kesh tu vdek. Qe, prezent e kam edhe Fatlum Demirin. Në të betohet që nuk ka qenë ashtu, unë tash e lëshoj kuvendin. Kallxone realitetin çka ka bë një kryetar siç është Sokol Haliti, kurse për konkurse, a ka të drejtë me i anulë kryetari a jo, është fat që e kam sot shefin e personelit

prezent, z.Hysen Ymeri. Kam dëshirë që ai me sqaru rreth këtyre 2 konkurseve, por mos më demantu diçka që është realitet, dhe ke qenë prezent ti bile. Unë të njof si burrë të madh, që fjala jote peshon. Jo me thanë me ma demantu mu. Qy ku ka qenë njeri prezent. E thirrmi Arianin, unë nuk dalë më në Viti. Nuk guxon me kap njerin për fyti. Unë në kompani teme private, që muj nesër me qit prej punës, nuk muj me kap për fyti, e po e kap në komunë. Kush është ai mbret? Nuk është, ai veç është diktator. Unë Kim Jong i kam thanë moti. Qysh po thu sheshi nuk u përfundu hala qe 2 vite? Kallxom ti mu, a po e shef Vitinë ma të bllokume sot a më herët. A ki ankesa ti prej bizneseve si unë që u blloku krejt Vitia? Ku e parkon kerrin ti kur të vjen në mëngjes? Po kjo është në interes që po më therrë mu, se unë çdo ditë jamë në Viti. Ti në mëngjes e le kerrin te komuna, në 4 hecë. Te puna e taksistave. I nderuari Aliu, dje kam dalë në 8:30 në mëngjes me pi kafe, më thanë a ka mundësi me u ndalë 5 taksista. Më thanë, Taulant, të lutem që, a beson që nuk jemi tu mujtë me ja dalë kurrqysh atë informatë. Dje e kam marrë, ata dje më thanë, a ka mundësi me dalë te vendi ku kanë qenë më herët, është kërkesë e tyre se e kanë për bukë të gojës. Ata jetojnë prej asaj, nuk kanë ka marrin. Ne e kemi bënë sheshin e me i lanë njerzit pa punë, e kemi bënë sheshin me blloku Vitinë. Hajt tregom ti, z.Aliu edhe një here se, që 2 vite u myt tu folë për këtë pjesë, tregom. Një mërgimtar niset ose prej Drobeshit në Viti ose prej Mediteranit, kur të niset për qytet, si mund të hy në shesh, ku mund me parku kerrin. Ne i kemi demtu bizneset, ja u kemi qu Gilanit e Ferizajt, bizneset e presin këtë sezon, korrikun dhe gushtin, rritet qarkullimi, puna, lëvizja. Me këto 2 muaj bizneset qarkullojn 10 muaj të tjerë. Krejt jemi tu i hup, ata si me sezon si pa sezon, se sheshi edhe bllokada e hapsorave të parkingut ja u ka bënë këtë. Edhe një herë po themë për punën e kryetarit. Trego si ka qenë, se ke përgjegjësi, je burrë i fjalës, nuk njof burrë më të madh se ti në LDK, as në Remnik. Ndoshta ka plotë, por unë nuk njof. Të lutem, trego realitetin se si e ka kap për fyti Arianin, edhe nuk je qu ti hiç, veç Melihatja.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** A ka burrë më të madh se unë në Remnik dhe në LDK, konsideroj që unë jam në mesin e më të voglëve, se ka qishit dhe në Remnik dhe në LDK. Ka edhe në parti politike tjera, ka, por faleminderit në vlerësim. Veç në rast se e ke përcjell veten qka ke thënë, se ke thënë në momentin që nuk ke lujtë ti hiç, të jep me kuptu që nuk ka pas kurgja dhe unë nuk kam çka përgjigjem. Në mometin që unë nuk kam lëviz, d.m.th me qenë prezent, unë edhe nuk kam lëviz, ajo tregon se nuk ka pas kurgja. Për këtë rast nuk ka qenë hiç policia, ka pas takim tjetër. Taulant, në moemtin që thu këtë fjalë, duhet me të ardh keq për personalitetin që po e merrë nëpër gojë. Në radhë të dytë, nuk bënë me thënë policia, se ata mundem me të bë kallzim penal për shpifje, mund me të bë. Policia vijnë për çdo ditë, nuk jan kanë për këtë çështje.

**z.Jakup Demiri:** Nënkryetar, te kjo pyetja ime e dytë që ishte te problemi i projekteve në Smirë, që u lidh muhabeti, se kjo ka të bëjë me të gjitha ato projekte që janë në tërë territorin e komunës, se na këtu i trajtojmë si të tilla. Unë jetoj aty, i shofë më shpesh. Është e vërtet që kontrata kolektive e ka marrë një pjesë të madhe të parave, por kjo ka ndodhë në Vitin e kalum me kontratën kolektive, por për këto projekte që po flasim, i kanë ka 4 vite, dhe problemi im është që, nuk ka qenë komuna serioze me këto probleme që jan shkaktu të qytetarëve. Ne në fshatin Smirë i kemi 3 lëndime serioze të njerëzve që janë lëndu aty. Është mirë me cekë aty, por ai trotuar ka paraqitë problem edhe familjarëve që fëmijët e vegjël duhet me i shqetsu, se edhe sot nuk guxojnë me i lanë vet me shku, se jan 3-4 vende të rrezikshme, ndërsa për te varrezat mendoj që edhe aty duhet me pas një përgjigje pakëz më konkrete. Çka keni me bë, se është dëmtu rruga prej punimeve. Ne me paret tona e kemi shtru. Deshta me u lidhë te puna e ministrit. Unë nuk kam dalë me minisitrin, nuk e kam parë të arsyeshme. Unë kam dalë vet i kam vizitu, e kam parë gjendjen si asamblistë veq vet, për mos me bë politike, ndërsa për zotin e shpisë, unë mendoj që zoti i shpisë nuk ka lënë vend, por ka dhe të tjerë. Nuk dua as ministrin me shfajsu, se mirë është me u lajmru në komunë, por i zoti i shpisë ndesh u pajtu, ndesh su pajtu, për me nivel qendror nuk ka lënë vend. E pikërisht me këtë farë ministrin e ka pas një proces gjyqësor, me të cilin kryetari ka humb. Ai nuk ka humb. Edhe e dimë si i ka raportet Ministri i Bujqësisë me Kryetarin e Komunës, ndërsa edhe unë nuk po e shfajsos, se përnjëmend është e rrugës kur të vjen dikush prej atjehit, me marr drejtorin a dikan, kjo nuk ka dilemë, e me ja ofru qytetarëve, se atë e kanë bizneset prioritar. Është e tmerrshme gjendja me pa, por këto janë fatkeqësi natyrore, duhet sa të mujmë me ju ndihmu.

**znj.Lindita Demelezi:** I nderuar Nënkyetar, me 27 mars kam kërku që të rregullohet koeficienti i punëtorëve në sektorin publik. Më keni thanë se, është formu një komision, d.m.th 3 muaj janë bërë prej asaj seance. Sa i vyen kohë komisionit që të rregullohet kjo çështje. Drejtor, thatë që ka shumë kërkesa për ndriçim publik. Nuk po kërkoj për një lagje, unë po kërkoj për 2 fshtara që lidhen, dhe është e rrezikshme, ka pas aksidente me fatalitet. Trotuari është i dëmtuar, është i mbluar me bari. Kisha kërku që të ndermirren masa dhe të bëhet kjo punë sa më shpejt.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Linditë, pasi po donë me qenë kaq konstruktive, nuk e kam bërë unë Ligjin e Pagave, e ka bërë qeveria jote, e ka aprovu. A ka mujtë në kohë mos me bërë këtë laramani? E i ka bërë krejt njëjtë, edhe ata tjerë nuk kanë pas rregullore në atë kohë. Asnjë faj nuk e kemi ne të Komunës së Vitisë. Krejt e ka pas dokumentacionin aty. Ofiqari është ofiqar, ata e dinë që nuk ka komunë pa ofiqar. Pse kanë bërë laramani.

**z.Nexhat Halili:** Drejtoreshë, tek banjot në Pozheran deklarove se nuk është bërë pranimi teknik i banjove. Pyetja ime është kështu: a ka pranimit teknik krejt objekti? Nëse nuk ka pranimit teknik për banjo: a ka pranimit teknik objekti? Tek mjeku në Sllatinë, ka një kohë të gjatë, nuk është puna veç 2 javë, te pastrimi i oborrit në Sllatinë, se drejtori tha në Pozheran, por unë e bëra për në Sllatinë aty nuk janë barnojat tepër delikate, që me një objekt të vogël mundet me u bërë pastrimi. Për rrugë drejtor, rrugët nuk janë pastru andej nga vijë unë. Ndoshta në këtë regjionin keni punu diçka, por një problem është se i keni 300 kilometra që i keni deklaruar në kontratë, e çmimi i 1 kilometri është 10 euro, e kompania me siguri neglizhon, se për 10 euro 1 km e neglizhon. Te grandit i performancës. Nënkyetar, unë e kam një dokument, po të tregoj prej DEMOS-it, ku vlera e grandit ka qenë 791 mijë euro, e kanë mbetur 105 mijë euro pa shpenzu, që janë kthyer mbrapa.

**z.Illir Zuka:** Drejtoreshë, faleminderit shumë që po ndermarrshe sot! Po deshta me u lidhë, se jam marr shumë me ambulanten. Pranimit teknik drejtoresha tha, mirëpo që janë tu punu tash, se aty para 1 muaji ka përfunduar punimet që u intervenu në banjo, përndryshe 3 banjo në Pozheran funksionojnë jashtëzakonisht mirë, se aty bëhen veç analizat, se nuk është punë objekti. A ka pranimit teknik, është punë që është tu punu kompania tash. Se kanë bërë pranimitin teknik dhe nuk është leshu.

**znj.Merrushe Ahmeti, drejtoresha e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale:** Nexhat, me shumë të drejtë e ceke kërkesen tande, dhe ke të drejtë, mirëpo kur e thasë pranimit teknik, e mendova në kontestin e përgjithshëm, që nuk është teknikisht si banjo. Në rregull se patjetër që objekti si i tillë e ka pranimitin teknik, se nuk ka sens me u punu një numër i konsiderueshëm i stafit dhe vizitorëve vazhdimisht mos të ketë pranimit teknik, mirëpo ke fjala vetëm për pjesën e banjove, teknikisht nuk janë në rregull, dhe për këtë arsye nuk janë funksionale, mirëpo kemi me i shiku nëse kemi mundësi me i fut në aspekte buxhetore, me i rregullu ato banjo. Sa i përket mjekut, sipas informacioneve që mi dergun menaxhmeti, se kanë të pamundur me manaxhu secilin individ, tregun që vetëm 2 javë. Nuk ka qenë shkak që u bartë në seli për arsyet e fluksit më të madh.

**z.Basri Aliu, drejtori i shërbimeve publike:** Sa i përket çështjes së taksistave, unë thashë që, kërkesa ka qenë e tyre me u bart atje, dhe muj me u ballafaqu me ta, sepse aty kanë qenë të vendosur dhe kanë kërku prej meje gjithsesi që me i bartë atje. E kanë caktu vet vendin. A kanë punë a nuk kanë, ndoshta edhe këtu nuk kanë pas punë, nuk do të thotë se sezona, sezona varet sigurisht, kur të vijnë tani mërgimtarët kanë me pas punë, dhe plus asaj, po përmenden edhe parkingjet. Vitia është e vogël, unë p.sh.: me ardh me kerr prej shpise është turp, po edhe ata çka vijnë prej jashtit i kanë diku 200-300 metra gjitha antë, kështu që, edhe sheshin e ka votu ky kuvend, e planin e mobilitetit. Kështu që, ne veç jemi tu zbatu vendimet që i ka marrë ky kuvend. Tjetër, të vijnë prej jashtit shumë na përkrahin në këtë drejtim, e dikujt po i pengon kjo. Ndërsa, sa i përket rrugës për me bërë me ndriçim, duhet me hy në projekt me votu edhe ju buxhetin, por ti edhe ashtu nuk e ke votu buxhetin, e tash po kërkon me hy në projekt, edhe që ka pas aksidente. Nuk është çështja e barnishtave që ka pas aksidete. Aksidete mund me pas prapë, se ka shpejtësi. Ato janë gjëra tjera. Ishalla kurr nuk ka askund, por po kemi edhe në rrugë magjistrale aksidete. Është mirë me i ndriçu gjitha rrugët, por janë gjëra që duhet me shku me rend.

**z.Sejdi Emini:** Po kyqem te stacioni meteorologjik. U gjujt faji, thanë ministria, e qendra që 25 vite është mujtë me mëndu për to. Nuk po du me marrë unë faj dhe përgjegjësi për askënd hiç, dhe kur është qytetari, mbi të gjitha e kemi qytetarin. Mua më vjen keq me gjujt faj anej knej, se barrën dhe dëmin e bart qytetari, mirëpo

mua më interson tash konkret, që 4 vite që jemi në qeveri: a keni qu projekt edhe kërkesë te ministria, me thanë që kemi nevojë për këtë gjë? Se jemi zonë që për çdo vit bujqësia dëmtohet kaq keq. E di që nuk e keni qu. Qysh po doni me ja u dhanë juve pa e qu? Ki 100 projekte që janë marrë në interes të qytetarit me qindra mijra euro. E ke rrugën për Samakovë, Kerbliq, Stubëll. Gjykatën, ato janë investime të Qeverisë. Qysh mundet me ta dhënë ty investimin për banim social, kur ti nuk e qon kërkesën kur ai të thirrë bjerne të jau jap, ti nuk e çon. Po nuk mundet me ja u dhanë qashtu. Nuk më interson kush është, si është, qytetari është mbi të gjitha, por obligimin duhet me krye ne si Komunë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Në rast se pyet, atëhere dhe prite përgjigjen. Me ra një këshilltar i kvuendit komunal pi ni niveli shumë profesional që po e thu, tani me një nivel shumë naiv, nuk po muj me kuptu. Nuk është sistemi kundër breshrit i aspektit komunal, është i aspektit shtetëror. As kërkesë nuk mund me bë. A e di çka po thu ti, mi thanë ushtrisë, FSK-së blej një airoplan. Ai e blen kur ti ka paret, e blen edhe helikopterin edhe e blen armatimin. Ata e kanë ingjizmin detal. A po mendon që nuk e kanë a! Në kuadër të ministrisë, e dinë edhe cilat nuk kanë qenë veç Vitia me ato bombat me shkri breshrin u kanë krejt krahina e Kosovës. Po nuk mund me i bë, se është askept shtetëror.

**z.Naim Pira, drejtori i bujqësisë:** Po mundeohem me qenë i shkurt, me respektu bile këtë rregullore të punës që e keni votu vetë. Unë e kuptoj që është fushatë zgjedhore, keni hy në fushatë zgjedhore. Me kërku diçka që nuk ke kompetencë, është më tepër se absurditet. Si drejtor i bujqësisë jam interesu për këtë çështje para teje, nja 4-5 here e kam bë në ministri, e kam bë në organe kompetente për këtë çështje, dhe thjesht kanë thanë, hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës e manxhon KFOR-i, dhe nuk lejon gjëra të tilla. Pikë! Për ty duhet me qenë shqetësuse me ngritë unë, që 2 vite jam tu i qu dëmet e shkaktume nga ana e fatkeqësive natyrore ministrisë, me ja kompenzu dëmin bujqëve. Nuk ja kompenzon. Ti pe lyp sistemin me ta vendos, që nuk është kompetencë e jotja. Kjo është absurditet, kjo është veç me bë llaf në kuvend, dhe ta fitoj një poen politik tek qytetarët. Nuk është korrekt kjo, nuk të lejon KFOR-i sistemin kundër breshërit, sepse ki të bëjë me raketa. Më thjesht unë jam intersu si drejtor.

**z.Taulant Haxhiu:** I nderuari Drejtor, unë thashë edhe një here, se di a më ngove me vëmendje. Ata nëse kanë bë një propozim më herët, ata sot po ju doket që kanë gabu me propozimin e vet. Veç, a mundemi prej atyhit me i bart ku dojnë ata? E sa i përket sheshit: a je tu e pa si tu ka blloku Vitia? Unë jam banor i Vitisë, edhe ti, por tjerët kur të vijnë, çfarë hapësire të parkingut kanë bre. Tregom ti mu, udha me kalldrëm a po të duket e mirë, po të duket investim i duhur për Viti në atë formë shtrimi i kalldrëmave që është bërë? A është kualitative ajo, a mund me hecë aty me veturë? Juve Remnikut nuk jam tu ju njoft a jeni ju a jo, krejt jeni tu fol kontrast. Veç thuj, si qytetar i vjetër i Komunës së Vitisë: a është kalldrëmi i mirë, dhe a është kualitativ, dhe a të pëlqen si është shtru aty? Nuk po të themë si i përket partisë politike, por po flas si qytetar i vjetër i Komunës së Vitisë.

**znj.Majlinda Shabani:** Jemi lodhë me kësi përgjigje. Veç arsyetime. Nënkyetari nuk qenka këtu. Kisha pas dëshirë me qenë këtu. Për sa i perkt kryetarit, Sokol Haliti, i kemi parë që për më manipulues, më mashtrues, më kryetar shpifës, në fund dhe sulmues, nuk ke se ku e gjenë. Leje pjesën e fushatës. Prej nga fillimi i mandatit kemi pas rsat në kuvend që ka ndodh sulmi fizik, tash kryetarin nuk e kemi prezent, pothuajse në asnjë seancë të kuvendit komunal. Pse nuk e kemi prezent kryetarin? Nënkyetari është tu mundu me gjetë arsyetim tek projektet të cilat po shkaktajnë vonesë për me u përfundu. Edhe tek buxheti, d.m.th që kontratë kolektive në këtë rast e paskan pamundësi dhe e paskan dëmtu buxhetin që mos me mujtë me i përfundu. Hajde qe e paskan dëmtu, por a munden me na tregu neve nënkryetari dhe kryetari, projektet që filllojnë dhe që përfundojnë, pse nuk kryhen siç duhet? Pse duhet një projekt brenda 1 vitit me intervenu 2-3 herë në atë projekt? Pse është dashtë në rrugën Viti-Ramisht, që është shtru ajo rrugë, me u ngushtu? A e din çfarë problematike shkaktan ajo rrugë me kalu 2 automjete? Na keni lodh me këto arsyetime. Ne jemi tu e pa se çfarë investime bëhen në Komunë të Vitisë dhe jemi tu e pa logjikën se si ka qeverisë ky kryetar. Qe sa vite qeverisje kemi pa, edhe si rezultat çka ka shkaktu kjo, e drejtori këtu, se tash po flasim këtu për sektorin e bujqësisë, po thotë kemi bë kërkesë. Nuk është kompetencë e jona, ti e din shumë mirë rastin. Tash nuk paskeni mujt me bë një kërkesë të tillë. A keni mujt me bë kërkesë për sistemin e ujitjes në fshatin Skifetraj, që ka qenë para disa viteve? E në fushatë Sokol Haliti

ka dalë ka shpif për zëvendës ministrin Imri Demelezin, ku ka edhe aktgjykim, i cili është rast i fitum, që e ka ndalë atë projekt. Arsyetimet ju mundeni me i gjetë menjëherë. Kur të është fjala ofertat që i ka bë qeveria për investime në Komunë të Vitisë, janë sikur asnjëherë më parë. E kemi pas projektin e përballueshëm social, ku kryetari, Sokol Haliti as nuk ka shpreh intersim dhe gatishmëri për me apliku. Mandej ka shku te ministria pasi është kry afati për aplikim, me i lut, edhe ka pa gabimin që është bërë. Po ajo nuk ka mujt me u kthy. E kemi rastin kur kryetari Haliti premton 4 çerdhe në Komunë të Vitisë gjatë fushatës së tij elektorale. Asnjë çerdhe e ndërtume prej kryetarit Haliti qe sa vjet qeverisje. E për këto 4 viteve të fundit, i ke 2 çerdhe investime që janë bërë prej Qeverisë Kurti. Çerdhja në Drobesh dhe Qifllak. E çka bënë kryetari Haliti, e bllokoi atë projekt që është shumë i nevojshëm për qytetarët e Komunës së Vitisë. Me konkurset që duhet me u zhvillu dhe duhet me u përfundu, dhe sa më parë me fillu.

**z.Jakup Demiri:** Për drejtorin e bujqësisë kemi pas rast këtu në Viti. Nuk e di a ke qenë ti apo nuk ke qenë, se ke qenë një kohë për shkak rrethanave që ke pas, por kryesuesi e dinë që neve na ka ik një vit pa e dorëzuar listën e fermerëve të dëmtum. Kam qenë edhe vet i kyqun në atë punë, po, se fillimisht kanë apliku vetëm pak, 13 apo 14. Kemi prit me rritë numrin, mandej kur e kemi dorëzuar u bë shumë vonë, pasi janë kry procedurat edhe nuk ka funksionu hiq me faj të komunës dhe kanë hupë. Drejtori, Basri Aliu po e sjell kryet. Nuk e di çka po kapeshe për çdo send te niveli qendror. Kur ishit në qeveri ju përpara, këtu ka qenë e ndalume e fol, se ne i kemi punët e tona. Tash veç gjuhi atje. Drejtor, asnjë punë nuk të ka bë për 3 vite. Ndriçimi në Smirë ka nejt ditë e natë ndez, nuk ke mujtë qato drita me i shkym, e ke nejt drejtor. Po nuk kisha nejt 1 minut drejtor. Ki projekte të pa kryme. Plot ke qe 4-5 vite, dhe këtu fol me komoditet. Duhet me të ardh marre, edhe pse nuk është faji yt, por e ke marrë detyrën, se këtu shpeshherë e kam thanë dhe po e themë, sot qeverisë vet Sokol Haliti, bash pa ju vetë hiq. Po është një rregull me pas nënkryetar, më fal nënkryetar, po më vjen keq që po e themë, edhe drejtorat. Ai bash për kurgja nuk konsultohet me juve. E dimë ne, këtu jetojmë, këtu punojmë. Po mos u gjuni muhabetet, jo ashtu jo kështu. Një punë nuk është kry nuk është kry bre. Trotuari në Smirë nuk është kry qe 4 vite. Në fshat u nis, as nuk ka qenë i planifikum, as i parapam, as nuk ka ditë administratori i fshatit. Ne mbajmë takime të rregullta në Smirë. As rruga kur është shtru te varrezat, sen nuk ka ditë as për këto. Mandej që janë bërë, që janë dëmtu kerkush nuk ka ditë. Ne e kemi edhe një listë të dorëzume në komunë para 10 viteve gati janë bërë. Projektet me prioritet në Smirë kurrë nuk janë marrë parasysh. Kështu qeveriset komuna jonë. Për këtë tana ka telashe. I ke 27 projekte të listume këtu. Ti kam tregu që kanë tejkalu çdo afat. Janë 27 projekte të cilat i kanë kalu 3 vjet e tepër pa u kry për atë KAB. Është shumë i rëndësishëm kur të hymë te KAB-i tani flasim, po problemi i barnishtave, i pastrimit të rrugëve e dimë si shkojm, se as 1/3 kompania nuk e kryen punën, e pagesat bëhen, se na në teren jemi. Te puna e ministrit apo e dëmeve, më shkurt për bujqit e skiferave, projektin e kanë bë, dhe kërkesë kanë qu në email, ministria ka thënë, dorëzoje projektin për sistemin e ujitjes në fshatin Skifteraj, kurrë nuk keni qu. Është njëfar lufte mes qeverisë komunale dhe qendrore. Mandej e dimë problemin e pagave. Vitin e kalum, që veç Komuna e Vitisë me kryeneqsi, gjithë ai problem u pat bë. Për çka! Që ta luftoj. Po ju kisha lutë që mos të hymë në këto nivele, kur kemi shumë probleme tona, kemi probleme, që qe 2 vite e ke sheshin këtu që unë kur kam ardh tash 1 vit kam thanë, me 15 korrik a mund me kry. Keni thanë po, kryhet. D.m.th të vitit të kalum. Dhe tani po vjen dhe 15 korriku tjetër pa u kry. Mos të harrojmë që, 2021 e 2027 i ke 3 kontrata për projekte me i bë komunës në vlerën 840 mijë euro të dhanta. E ke këtë gjendje me projekte. 1 milion euro i jep gati komuna për me i hartu projektet e komunës, dhe e kemi këtë gjendje. Asnjë projekt nuk e ke të detajum. Fillon projekti, tani masanej elaborati, ndërhyrjet, kurr nuk kryhet.

**z.Naim Pira, drejtori i bujqësisë:** Kisha pas dëshirë të kursehemi në fjalor, sepse jemi para qytetarëve, dhe unë e di që shkon seanca live dhe japin një mesazh te keq edhe te fëmijët tanë, edhe te qytetarët në raport me fjalorin. kjo ishte si kerkes e imja dhe si mandar që kam qenë për 8 vite i kuvendit kam aps kujdes në këtë aspekt dhe nuk kam toleru gjera të tilla. Sa i përket vërejtjes, unë në 2023 kam pas gjendjen shëndetësore çfarë e kam pas, por të jesh i bindur që nga atje i kam përcjell seancat e Kuvendit të Vitisë. Vitin 2022 ka ardh udhëzimi administrativ, që i ka marrë kompetencat Ministria e Punëve të Brendshme. Deri në vitin 2022 janë kompenzu dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme elementare natyrore që kanë ndodhë në vitin 2023. Para kuvendit

i ka prezantuar dëmet në kuvend komunal. E kam përcjell nga atje z. Avni Misini dhe unë, kam dëshmi edhe 2023 edhe 2024 që ju kanë dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe mbetet vlerësimi i dëmeve për kompenzim. Nuk ju ka kompenzuar asnjë cent. Shpresoj, uroj që mas sotit, pas kësaj fatkeqësie që ju ka ndodhur në një pjesë të regjionit Komunal të Vitisë të ja kompenzoj, se ajo është në interes të qytetarëve. Kjo do të kishte qenë më e mira, dhe unë si apel po e bëj, edhe nga këshilltarët komunal, por edhe nga ju që keni pushtetin tash në nivel qendror, të bëjmë presion, se bujku fundi fundit nuk i takon asnjë partie politike, bujku punon tërë vitin dhe në fund ja merr për 10 minuta fatkeqësia natyrore bereqetin. Është e dhimbshme për të. Mos të manipulohet dhe mos të kërkim të marrim vota nga bujqit.

**z. Basri Aliu, drejtor i shërbimeve publike:** Për fjalor e përkrahi edhe Naimin, por është edukata e dikujt që e përdor atë fjalor nuk do të ndërhyj. Unë e sjella kryt, sepse nuk është e vërtetë ajo çka e the, sepse unë vet kam qenë sa ka qenë drejtori në shërim atje, dhe me komisionin kam kontaktuar, listën e kanë pranuar, e kanë shti, e kanë kaluar krejt, por pse s'janë paguar, ajo është pyetje tjetër, atë nuk e di. Me rëndësi Komuna e Vitisë i ka kryer obligimet e veta që u dashën në mënyrë procedurale. Dikush po thotë qyteti i bukur i Vitisë, por këtë të bukurin kush e ka bërë? Dikush e ka bërë.

**Kryesuesi, z. Bekim Azizi:** Falemiderit për debatin! Shkojmë me 5 minuta pauzë derisa të qetsohet situata. Vazhdojmë pas një pauze të shkurtër.

**z. Hysen Ymeri, shef i personelit:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kërkesa për sqarim, për veprimet e fundit të kryetarit të komunës, përkatesisht nënkryetarit, lidhur me anulimet e konkurseve publike. Edhe herën e kaluar pas përfundimit të zgjedhjeve qendrore, 9 shkurtit, e mbani mend, jam deklaruar publikisht, përkunder, mandej që i kam pas disa gjykime edhe verbale nga pak, se unë gjoja kam bërë interpretimin keq, dhe kam bërë me tendencë. Nuk e kam me tendencë, e kam që institucionet komunale me dal mirë me veprimet e tyre ligjore. Vendimet e fundit po mundohem me i ndërlidh me vendimet e më hershme, e mbani mend të nderuar këshilltar dhe ju kryesues, unë jam deklaruar publikisht, nëse fjala ime është ajo që dikush e konsideron se është tendencioze, dhe është me prapavi, atëherë unë mbaj përgjegjësi penale për aktet dhe veprimet të cilat janë bërë. Fatmirësisht si kam thënë unë ashtu ka dalë. Palët e pakënaqura kanë nxjerrë afatet e tyre ligjore, përkundër se nuk ju është dhënë një aktvendim ose me vendim të kryetarit, dhe kanë shkuar janë anku në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës ka thënë ashtu si jam deklaruar unë, vendimet e kryetarit të komunës janë vendime të kundërligjshme, të paarsyetuara mirë dhe në kundërshtim me Ligjin mbi Procedurat Administrative, që do të thotë unë atëherë kam pas me vend. D.m.th kam qenë kundër këtyre veprimeve, sepse duhet me u bërë aktet ashtu siç duhet, siç i ka paraparë ligji, në nderkohë që nuk janë bërë. Ke këto veprime të fundit, janë nxjerrë 2 vendime të Kryetarit të Komunës, përkatesisht nënshkruar është nënkryetari. Mua hiç nuk po ma rrok mendja kështu si jurist, që vendimet e Kryetarit të Komunës i anulon nënkryetari, vartësi i tij. z. Nënkryetar, këto vendime i keni nënshkruar ju, nuk është dashur me i nënshkruar. Herën e kaluar kam deklaruar se, vendimet duhet të jenë konform ligjit, ta kenë hyrjen, dispozitivin, arsyetimin. Edhe këto 2 vendime nuk kanë përmbajtje, por nga forma në rregull jemi, por përmbajtjen nuk e kanë ashtu siç ka thënë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës me rastin e anulimit të vendimeve, përkatesisht konkurseve. Herën e kaluar në njërin vendim thuhet: duke marrë parasysh mungesën e një raporti nga ana e zyrtarëve të DKA-së, për nevojat e arsyetuara të pozitive, dhe mungesën e koordinimit të zyrave përgjegjëse. Kush e merr vesh, zyra përgjegjëse është Njësia e Burimeve Njerëzore. Ne jemi konsultuar, asnjë veprim nuk bëhet pa planin e personelit. Së pari bëhet plani i personelit, pastaj fillojnë procedurat e rekrutimit. D.m.th nuk keni bërë asgjë, kështu që, krejt këto kërkesa të protokoluara. Fjala është për drejtorin e arsimit, që i bjen, këta i kanë dorëzuar Njesisë për Menaxhimin e Personelit, për t'i proceduar tutje, që do të thotë edhe rastin e çerdhës, përkatesisht edukatoreve dhe stafit teknik. E tani pas shqyrtimit të gjitha rrethanave që lidhen me zhvillimin e konkursit për pozitën edukatore, vlerësoj se ka arsye të mjaftueshme administrative për anulimin e këtij konkursi, por nuk ka arsye, asnjë arsye nuk është pse nuk është, sepse ne jemi kanë në fazën e verifikimit, as komision nuk kemi pas. Është pritë me u formuar për arsye se këtu ka një dallim kohor mes zyrtarëve publik. Fjala është për të arsimit, stafit mbështes dhe teknik. Këta kanë procedurë tjera. Afati ligjor 15 ditë. Këta e kanë 30. D.m.th këta janë vonuar për 15 ditë, që do të thotë unë kam qenë në procedurë

të verifikimit të dokumentacionit të kandidatëve. Fatkeqësisht 41 janë, të gjithë janë me fakultet. Tash në ndërkohë menjëherë kemi një ndërhyrje këtu, dhe thuhet, ky vendim merret për të garantuar respektimin e ligjshmërisë, zbatimin e parimit të barazisë dhe transparencës, si dhe sigurinë e një procesi të denjë për të gjithë kandidatët. More nuk kemi fillu në proces ende, nuk jemi në proces të testimit, edhe me shkrim edhe me gojë, jemi larg, jemi në procedurën e rekrutimit, d.m.th është bërë 15 ditë përpara. Edhe tjetra, as në këtë vendim nuk ka këshilla juridike. Ligji për Procedurën Administrative i parasheh se çfarë duhet të ketë një akt administrativ, thotë neni 47, pjesa hyrse, pjesa e urdhërdhënësit, dispozitivi, pjesa e arsytimit dhe këshillat juridike. D.m.th palës duhet të ju tregohet ku duhet të shkoj. Rastin e kemi këtu më së miri me anulimin e konkursit për kuzhinierë. Këtu ka fitues, ka dalë, prandaj këtu është dashtë të ju thuhet, pala e paknaqur ka të drejtë të shkoj në komisionin e ankesave. Pastaj nëse nuk i arrinë qëllimet vetë, ajo duhet të shkoj në gjykatën komunale, jo në Këshill të Pavarur. Dhe thotë kështu: konkursi është anuluar pasi që asnjë anëtarë nuk është i fushës kuzhinierë siç e përcakton neni 11 i kësaj rregullore. Jo kështu nuk është, edhe kjo është keq, sepse mund të mos kemi kuzhinierë, por në vendimin të cilin ja kam përgatit në kryetarit të komunës, thuhet: në mbështetje të Ligjit mbi Zyrarët Publik, Rregulloren për Procedurat e Rekrutimit të Stafit Mbështetës dhe Teknik, neni 11, pika 2.1 dhe 2.3, dhe 3 nuk e kërkon me qenë kuzhinierë, dhe ky vendim është profesional, nuk ka sen që e ndal këtë, nuk ka jurist në Kosovë që e ndalë këtë pikë. Zijadin Ahmeti, Arian Alidema, Shqipe Lubishtani dhe barazia gjinore, një profesore dhe e gjinisë së kundërt, dhe është përfaqësuesi këtu, çka ka të keqe këtu nese ka pas shkelje këtu, atëherë është dashtë me dhanë këshilla juridike sipas ligjit palët e pa kënaqura. Nuk është asnjëra për fat të keq shumë. Po themë publikisht, këtë punë e ka bërë keq nënkryetari i komunës dhe Zyra Ligjore dhe ata 9 jurista të tjerë që janë aty, sepse kërkund nuk ka akt administrativ. Nëse ma gjenë dikush këtu në ligj, nëse nënkryetari i komunës i anulon vendimet e kryetarit të komunës, unë po shkoj 1 vjet përpara në shpi, po e la administratën komunale. Kështu, prandaj ka shkelje dhe nuk është mirë nëse unë këtu i themë publikisht, se publikisht jam tu i thanë, ajo ana anej ka ajo zyra e bardhë anena, me qu lloj lloj msiti aty me më thanë, ti Hysen Ymeri mos fol shumë palidhje, se po e akuzon kryetarin. Nuk jam tu e akuzu kryetarin, pikërisht unë jam tu e mbrojt. Nuk ka Kryetari i Komunës, Sokol Haliti për veprimet e mia, asnjëherë kurr nuk e ka thirrë as policia, as prokuroria, as Agjensia Antikorrupsion, askush hiq deri sot, sepse unë qëndroj para këtyre vendimeve që i kam hartu, dhe kur ta hartoj unë nuk e shti njerin llugave siç thotë populli, prandaj këta tjerë, nënkryetari, Zyra Ligjore, Albulena Haxhiu dhe të tjerët aty që rrinë, e keni pru edhe një here me shkelje, e keni pru kryetarin e komunës në pozitë jo të mirë juridike, sepse njerëzit ankohen, sepse njerëzit janë tu pru aneksa, prandaj sugjeroj, sepse unë e di, tashti thotë që konkursi publik për çerdhe me u anuluar. Unë e di që kanë me u marrë me e **Endomedin**, nënshkruetin e kontratës etj, por njerëzit mundën me fitu kontestin, dhe unë ta garantoj qysh doni, me përgjegjësi penale, se këta, fituesi që kanë fitu këtu 100% kanë me fitu kontestin. Prandaj, nuk dua me pru në lajthim kryetarin e komunës, dhe tash nuk e di a unë që po i themë mos hynë në shkelje ligjore, a ata që po i thonë mashalla që e ki mirë. D.m.th, unë jam ai që jam tu i thanë Kryetarit të Komunës, mos vepro kundërligjshëm, sepse ka thënë vendimi i Këshillit të Pavarur. Dhe është interesant me vendimin e Këshillit të Pavarur. Janë 6 persona, 5 janë të LDK-së, kryetari është i LDK-së, ish kryetari i degës së LDK-së, d.m.th qaq është shkelje, sa edhe atij nuk ja ka marrë mendja me hy llogave, se përgjigjet penalisht. D.m.th, qe ku e ka shkru, këto janë shkelje, prandaj unë e lus kryetarin e komunës edhe njëherë, mos ta merrë asnjë veprim të llojit të tillë të kundërligjshëm, se përndryshe krejt për fund u bëmë kare. S'ka lidhje pse është fushatë. I ki 200 konkurse nëpër krejt Kosovën, krejt kanë të drejtë të shpallin konkurse përditë ministritë, komunat, krejt të tjerat. T'i lajmë këto gjëra, mos të shkelim, nëpërmjet meje shkeljet nuk kalojnë. Faleminderit shumë!

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Po të tregoj të drejtën, unë dashta me të respektu kryesues, se e mbylle, edhe pse pata kërku fjalën, por për shkak të ambientit të krijum, unë do të jem shumë i shkurt. Menaxher i personelit, po të drejtohem, në rast se i ke përcjell punimet e këtij kuvendi sot, po flas, dhe thuhet se, një kryetar i komunës është të cilin nuk e vet askënd dhe del sipas teje, se një nënkryetar i komunës është më i madh se kryetari, dhe ja prish vendimet. Me të vërtet nuk e di si ka me lanë. A jam qaj më i madhi që i prishi vendimet, dhe tjetra, apo është një kryetar i komunës që nuk e pyet askënd, për sqarim të opinionit po e themë, kryetari i

komunës, gjithherë në koordinim nga lamia në të cilën vjen. Unë pajtohem se ti je i përgjegjshëm para ligjit, duhesh me qenë, nuk je i përgjegjshëm shkon në burg, por ashtu edhe kryetari është i përgjegjshëm para ligjit. Edhe këtë çështje veq këtu duhesh me i bashku të dyat. Ligji e kap edhe kryetarin edhe nënkryetarin e komunës. Ti po don me i bishtnu. Ti e din fortë mirë se, në mungesë të kryetarit, që ai e ka pas një rast të rënd familjar të vetin, dhe kur e ka marr vendimin, ju ka drejtu Zyrës Ligjore. Ti shko bjere vendimin. Në rast se nuk jam unë i nënshkrum nënkryetari i komunës, nuk e kam nënshkrum si Hasan Aliu, e kam nënshkru që e zëvendësoj kryetarin, dhe ai vendim është i kryetarit të komunës, nuk është i nënkryetarit, dhe nuk i iki asaj, se është e drejtë e imja me zëvendësu, ligji ka thënë ashtu. E thu se duhet të përmbahem. Çdo jurist ka metodologjinë e vet, po i ik thelbit. Zyra Ligjore ka pru atë vendim në atë formë, tu bazu në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, se kryetari në procedurë administrative është shkallë e fundit, dhe nuk ki të drejtë ankese. Ke të drejtë ankese, por jo në komunë më, i drejtoresh organeve gjyqësore, dhe këtë e dinë ata, dhe këtë çështje. Në rast se për 11 vite e 6 muaj e ke një rast, nënkryetari i komunës që të ka ardh në zyre, apo të ka interferu, apo të ka thënë se kam edhe familjar qaty, rritja atij koeficientin, nuk të kam ndërhy kurrë. Shumë e pastër është kjo punë, se jam i tillë, edhe me mu shkel, edhe kur e meriton me ligj, i vjen koha i rregullohet, po. Po të drejtohem ty këshilltare e kuvendit komunal. Këtë fjalor të cilën e përdore në fund për kryetarin, shko përdore në subjektin tand politik, nuk ke nevojë me më mësu mu, për shkak se ne e kemi propozu për 3 mandate, ka fitu, i kemi besu punës së tij, e kemi propozu, dhe për herë të 4-ër, dhe në rast se ai më dëgjon mu, konsideroj se në momentin kur është nominu, nuk ka çka lyp më në kuvend, se gjithçka është fushatë, se ju po e bëni. Prandaj çështja e rrugës prej Vitisë në Ramnisht nuk është e ngushtume, është e zgjanume.

**z.Hysen Ymeri, shef i personelit:** Unë këto 2 vendime po i konsideroj si ato tjerat, tërësisht të paligjshme. Aq më keq kur ju e keni nënshkru, sepse jeni profesionist i fushës kogjo gatë. Kjo mu më brengos, se nuk është një jurist i fushës. Mundet edhe mos me i ditë, pajtohem me atë punë, por kur aty ju ka juve, Albulena Haxhiun dhe atë tjerët juriste, ty, dhe ky vendim bie i kundërligjshëm, përkundër se Këshilli i Pavarur të ka tregu se është i kundërligjshëm, unë këtu koment më nuk kam. Për mua janë të kundërligjshëm.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Veç një pyetje. A i merrë ti pasojat e atij vendimi? I marrim ne.

**z.Hysen Ymeri, shef i personelit:** Po të kishte prokurori siç duhet, dhe ta nin këtë debat këtu, mes meje dhe teje në kuvend, atëhere duhet me thirr sipas juve, duhet me thirr edhe menaxherin e personelit, se si ka vepru, sepse keni thanë aty në vendim që, nuk ka pas koordinim. Jo, ka koordinim, se këto letra të Drejtorisë së Arsimit asnjë nuk janë të miat, krejt janë me vula, me kërkesa që kanë ardh te unë për me procedu. D.m.th unë kam procedu sipas ligjit, ju keni ndërhy. Aq më keq nënkryetar i komunës, ti edhe Albulena Haxhiu. Keq, për bes keq.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka për debat, vazhdojmë me rendin e ditës. Materialin e keni marë me kohë.

## R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit Komunal.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Propozim-Vendimit për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë për periudhën 2026–2028.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Propozim-Vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2026.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Propozim-Vendimit për shfuqizimin e vendimit me nr. 01-110/05-402, datë 30.04.2025, për miratimin e planit ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për komunat e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Parteshit, Killokotit, Ranillugut, Ferizajt, Kaçanikut, Shtimës, Han i Elezit dhe Shtërpces.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet rendi i ditës? Pra, e qes në votim. Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet dhe rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës.

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Kuvendit Komunal**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat e qes në votim. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet dhe procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

### **2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë 2026-2028**

**z.Berat Zuka, zyrtar i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa:** Përshëndetje për të gjithë të pransihmit! Në mungesë të drejtoreshës, do ta prezantoj Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028. Me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026, 01 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Komuna e Vitisë ju ka qas hartimit të një dokumenti fillestar që i paraprin planbuxhetit për vitin 2026, si dhe vlerësimet për 27 dhe 28. Buxheti i Komunës së Vitisë përbëhet nga 2 burimet kryesore: grandet e performances dhe të hyrat vetanke. Grandi qeveritar si grand i përgjithshëm është i njëjtë në krahasim me vitin 2025, për shkak se deri në këtë vit është marrë parasysh regjistri i popullësisë i vitit 2011, që ka qenë Komuna e Vitisë e prezantume me 46 mijë banorë, kurse kësaj radhe korniza është e prezantume me vitin 2024, që i përfaqësojnë 35 mijë e 500 e diçka banorë, çka do të thotë që, grandit i përgjithshëm është i njëjtë. Grandi specifik i arsimit ka rritje vetëm 312, grandit i përgjithshëm i shëndetësisë ka 411 mijë e 748 euro, si dhe të hyrat vetanke prej 24 mijë 533 euro. Bëhet pyetje se, të hyrat vetanake janë të vogla, mirëpo ashtu komisioni i grandeve ndërministror ka përcaktuar, sepse ne për çdo vit po kemi rritje të buxhetit për të hyrat vetanke në vlerë afër 230 mijë euro. Planifikimi jonë ka qenë 1 milion e 350 mijë, mirëpo ata e kanë parapa që edhe në vitin 2026 me 1 milion e 294 mijë e 260 euro. Çka do të thotë që, transferet qeveritare të të gjitha grandeve kapin një shumë prej 17 milion 029 mijë e 555 euro, dhe të hyrat vetanake 1 milion e 294 mijë e 660 euro. Total buxheti për vitin 2026 do të jenë 18 milion e 324 mijë e 211 euro. Themë nuk është një dokument ekzekutues, por është një dokument paraplanifikues i planit të buxhetit. Jemi udhëzuar në bazë të qarkores buxhetore që, pagat t'i planifikojmë duke mos i ndryshuar koeficientat e muajit mars, mirëpo duke e rritur nga viti i kaluar për një koeficient për çdo punëtor që ka planifikim real të pagave vjetore. Kemi ndryshim tek shëndetësia primare për 70 mijë euro rritje të buxhetit për pagesën e kujdestarive dhe pagesave jashtë orarit të punës. Te zjarrfiksat kemi për 30 mijë euro. Nuk e dimë, ndoshta ka qenë mirë edhe të shërbimet e shëndetësisë sociale, mirëpo nuk jemi afruar ta shohim në planin e buxhetit. Si duket edhe këta e kanë të drejtën, mirëpo ne si zyrtar financiar nuk kemi njohuri, se edhe këta duhet të paguhet për shpeznimet e pagesës jashtë orarit të punës, çka do të thotë që, totali i buxhetit e kemi me 61% prej 64. Krahasimi i buxhetit në paga 2025 dhe 2026 është me një vlerë prej 1 milion 407 mijë e 772, nuk është buxhet final, sepse qarkorja e dytë buxhetore na e përcakton kategorinë dhe Ministria e Financave sikur ne që e bajmë analizën edhe ata e kanë të njëjtat shënime tona, edhe e shohim qarkoren e dytë buxhetore, se sa na vijnë kufiri i pagave. Te kategoria shpenzime, mallra, kemi zbritje prej 94 mijë euro. D.m.th që, zbritja më e madhe është bërë në Drejtorinë e Planifikimit dhe Urbanizmit, që kanë qenë 110 mijë euro. Për hartat zonale 100 mijë euro, është bërë pagesa dhe 50 mijë euro kemi obligime në vitin e kaluar, dhe për këtë është bërë zbritja, mallra dhe shërbime. Te komunal kemi bërë zbritje për 10 mijë euro, kurse tek subvencionet dhe transferet është shuma 925 mijë euro. Zbritja është buxhet fillestar, vlerësimi jonë është ky, mirëpo departamenti i buxhetit komunal në kuadër të Ministrisë së Financave i bënë analizat e veta dhe në kufijt final në kategorinë ekonomike do të na vijnë me qarkoren e dytë buxhetore, dhe do të procesojmë. Nuk është e rrugës t'i prezantojmë edhe disa pengesa personale. Kam pas lëndime në këmbë, kemi pas shumë probleme me pagesat e kontratës kolektive, kemi gjetë mjete, nuk na kanë marrë mjete, por kanë shkuar në disa projekte, madje na kanë prekur te shërbimet, mallra, dhe shërbimet me një vlerë të madhe, dhe te shërbimet e shëndetësisë primare. Nuk i kanë marrë sugjerimet tona. Vlera e kontratës kolektive deri më tani është afër 2 milion euro. Çka do të thotë që, shumë projekte kapitale, edhe pse janë duke punuar, fakturat na kanë mbetur në dorë. Mos ta zgjas më shumë. Pasi që materialin e kemi marrë me

kohë, dhe dokumentin me disa gabime teknike që i kam përmirësuar, dhe besoj se do të aprovohet nga ana juaj për ta dërguar.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** E dimë që korniza buxhetore është në aspektin ligjor, që në qershor duhet të miratohet që të hapet rruga për diskutim publik për qarkore tjera buxhetore, që në shtator të bëhet miratimi i buxhetit.

